



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues UET

Nr. Prot. 4-17 Data 6.1.20

Shkurtimi i lëndës: Marrëveshje bashkëpunimi UET - AIDSSH /
vendimi nga UET për autorizimin e personave të kontaktit me
AIDSSH

Për trajtim nga:	
(struktura të tjera të ngarkuara)	
Me porosi:	

Afati: Normal(7ditë) | Prioritet(3ditë) | Urgjent(brenda ditës) | Pa afat/për djepi | Tjetër _____ ditë

Data 17.1.20, Nr. Prot. 55,55/1

Nënshkrimi(TITULLARI) _____

U njohën anëtarët:

1.	
2.	
3.	
4.	

Marrë në dorëzim _____,

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____,

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim _____,

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____,

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim _____,

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim Specialistit: _____,

Me porosinë: _____

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____,

Specialisti

Trajtimi i materialit pranuar më: _____,

Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më: _____,

Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më: _____,

Eprori në shkallë hierarkike



Datë 16 / 1 / 2020

Nr. 04 Prot.

Tiranë më 15/01/2020

VENDIM

Në zbatim të neneve 39 e vijues të ligjit nr. 80/2018, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neneve 20.3.4 dhe 21.3 të Statutit të Universitetit Europian të Tiranës dhe Rregullores së Universitetit Europian të Tiranës;

Vendosi:

1. Autorizimin dhe përcaktimin si personi zyrtar për mbajtjen e kontakteve dhe komunikimet/ndjekjen e procedurave përkatëse me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit:
 - Zëvendësrektorin për Kërkimin Shkencor në Universitetin Europian të Tiranës;
 - Zëvendësrektorin për Zhvillimin Institucional dhe Studentët në Universitetin Europian të Tiranës;
2. Të ushtrojë kompetencat sipas Statutit të Universitetit Europian të Tiranës dhe Rregullores së Universitetit Europian të Tiranës si dhe Marrëveshjes përkatëse, përveç atyre që si pasojë e ligjit, akteve nënligjore si dhe akteve rregulluese të Universitetit Europian të Tiranës janë kompetencë ekskluzive dhe të pa delegueshme të Rektorit.
3. Për veprimet e autorizuara, zëvendësrektorin/ët i raportojnë Rektorit.

Ngarkohet Zyra e Burimeve Njerëzore dhe organet përkatëse për zbatimin dhe vënien në dijeni të këtij Autorizimi.

Rektori

Prof. Dr. **Nevila NIKA**





AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"U.E.T." Sh.p.k.

Ne Tirane, sot me date 19.06. 2006, perpara meje , Pranvera Karafili notere e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht personat:

- Z. Henri Sherif CILI, shtetas shqiptar, lindur ne Elbasan, Shqiperi , me 05.11.1975 mbajtes i pasaportes n.-0012378, banues ne rruga: " Dervish Hima" nr.1, Tirane, Shqiperi;
- Z. Ermal Kujtim HASIMJA, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, Shqiperi , me 08.09.1975, mbajtes i pasaportes n.0013151 banues ne rruga: " Mujo Ulqinaku" Pallati Ndertuesi 10, Shk 1. Ap. 7/A , Tirane, Shqiperi;
- Z. Adri Agron NURELLARI, shtetas shqiptar, lindur ne Berat, Shqiperi , me 09.06.1979, mbajtes i pasaportes n.Z 0067090, banues ne rruga: V. Zaloshnja 10, L. 28 Nentori, Berat, Shqiperi;
- Z. Blendi Refik KAJSIU, shtetas shqiptar, lindur ne Durres, Shqiperi , me 11.4.1977, mbajtes i pasaportes n.0012823, banues ne rruga: "Lagja 6, Rr. A. Goga, Pall. 1026 , Durres, Shqiperi;
- Z. Laert Seit DURAJ, shtetas shqiptar, lindur ne Tepelene, Shqiperi , me 10.11.1972, mbajtes i pasaportes n. Z0070985, banues ne rruga: "Medar Shtylla" Kompleksi Erald, Tirane, Shqiperi;
- Z. Robert Pellumb RAKIPLLARI, shtetas shqiptar, lindur ne Korce Shqiperi , me 25.12.1975, mbajtes i pasaportes n 0013291, banues ne rruga: "Rr. E Kavajes, Pallati prane NPV" , Tirane, Shqiperi;

te cilet, me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne pranine time, nenshkruan kete akt themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " U.E.T." Sh.p.k.

Neni 1

Forma e shoqerise

Ortaket themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e secilit prej ortakeve eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te derdhur, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjeter.

Neni 2

Emertimi i shoqerise

Emertimi i shoqerise eshte "U.E.T." Sh.p.k.

Neni 3

Baza juridike

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit e Aktit te Themelimit.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

- te kryeje dhe te marre pjese ne te gjitha aktivitetet dhe bizneset qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te kryeje ne baze te legjislacionit shqiptar per ngritjen dhe funksionimin e shkollave te larta jopublike te nivelit universitar per shkenca sociale dhe/ose politike
- te organizoje programet e edukimit profesional, seminare, kurse dhe trajnime;
- perkthimin, pergatitjen per botimin, botimin , shitjen e gazetave, revistave, librave artistike, historike, tekniko-shkencore, monografive, fjaloreve, teksteve shkollore, botim dhe tregtim shtypshkrimesh
- si dhe cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Per te realizuar qellimet e saj Shoqeria mund te siguroje dhe perdore financime nga ortakët, nga vende te tjera ose nga institucione financiare vendase ose te huaja.

Objekti i shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te Asamblese te Ortakeve.

Neni 5

Selia

Selia e Shoqerise "U.E.T." Sh.p.k. eshte ne adresen: Rruga: " Rr. Gjergj Fishta, Kulla Nr. 2 Blu, Nr. 56. Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te hape dege dhe filiale brenda dhe/ose jashte vendit

Neni 6

Kohezgjatja


Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe te pacaktuar kohore.

Neni 7

Kapitali i shoqerise

Kapitali themeltar i shoqerise "U.E.T." sh.p.k. eshte 100 000 (njqind mije) Leke, i ndare ne 100 pjese me vlere nominale prej 1.000 (nje mije) leke secila. Kapitali i shoqerise eshte nenshkruar dhe derdhur plotesisht me te holla ne dore, respektivisht nga ortakët:

- Ortaku Z. Henri CILI, zoteron 10% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 10000 (dhjete mije) Leke.
- Ortaku Z. Ermal HASIMJA, zoteron 57 % pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 57000 (pesedhjete e shtate mije) Leke
- Ortaku Z. Adri NURELLARI, zoteron 10% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 10000 (dhjete mije) Leke
- Ortaku Z. Blendi KAJSIU, zoteron 10% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 10000 (dhjete mije) Leke
- Ortaku Z. Laert DURAJ, zoteron 10% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 10000 (dhjete mije) Leke
- Ortaku Z. Robert RAKIPLLARI, zoteron 3% pjese te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes



prej 3000 (tre mije) Leke

Neni 8

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem.

Administratori i pare i shoqerise eshte Z. Ermal Kujtim HASIMJA, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, Shqiperi, me 08.09.1975 mbajtes i pasaportes n.0013151 banues ne rruga: " Mujo Ulqinaku" Pallati Ndertuesi 10, Shk 1. Ap. 7/A, Tirane, Shqiperi;

Administratori do te qendroje ne detyre deri ne revokimin e mandatit te tyre nga Asambleja e Ortakeve. Administratori mban pergjegjesi individuale perpara shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjit dhe/ose te Statutit.

Neni 9

Viti financiar

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Ai fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.

Perjashtimisht, viti i pare financiar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe do te mbyllet me 31 Dhjetor 2006.

Neni 10

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbyljes se cdo ushtrimori, pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

Neni 11

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "U.E.T." Sh.p.k., eshte hartuar ne 10 (dhjete) kopje ne gjuhen Shqipe me fuqi te njejte ligjore dhe jane nenshkruar rregullisht nga ortaket themelues.

ORTAKET:

Z. Henri CILI

Ermal Hasimja
Z. Ermal HASIMJA

Z. Adri NURELLARI

Adri Nurellari


Z. Blendi KAJSIU

Laert Duraj
Z. Laert DURAJ

Z. Robert RAKIPLLARI

NOTERI

Pranvera Karafili



Pranvera Karafili

STATUTI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"EUROPEAN EDUCATION INITIATIVE" SH.P.K.

Sot, me date 12/10/2018 (dymije e tetembedhjete), i pranishem:

- **EUROPEAN EDUCATION INITIATIVE HOLDING sh.p.k.** person juridik i se drejtes shqiptare regjistruar me NIPT I.61419036L dhe perfaqesuar nga **Z. Perparim Xhafa**, shtetas shqiptar, lindur me 24.09.1967 ne Kruje e banues ne Tirane, mbajtes i Leternjofimit ID me Nr. 025179654 dhe me numer personal G07924029Q, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

i cili ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise, me vullnet te lire dhe te plote, bazuar ne legjislacionin shqiptar si:

- Kushtetuten e Republikes se Shqiperise;
- Ligji Nr. 9901, Dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9723, Dt. 03.05.2007. "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar;
- Kodi Civil i Republikes se Shqiperise i ndryshuar;
- Gjithashtu bazuar dhe ne gjithe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Miraton kete statut.

NENI 1
EMERTIMI

Kjo do te jete nje shoqeri e se drejtes shqiptare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "EUROPEAN EDUCATION INITIATIVE" dhe emri tregetar i shoqerise do te jete "UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANES".

NENI 2
SELIA

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane, ne adresen: Bulevardi Gjergj Fishta, ish-NPV 2, Tirane, Shqiperi. Asambleja e pergjithshme e ortakeve mund te vendose krijimin ose mbylljen e selive dytesore, filialeve, zyrave te perfaqesimit dhe degeve te shoqerise ose transferimin e selise se shoqerise ne qytete te tjera si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj.

Vendbanimi i ortakeve per te gjitha marrredheniet me shoqerine eshte ai qe rezulton nga akti i themelimit ose nga njoftimet e mevonshme te tyre derguar prane selise se shoqerise.

NENI 3
OBJEKTI

Objekti i Shoqerise eshte:



Veprimtari ne fushen e perkthimit ,botimit,shitjen e gazetave, revista, libra artistik, historik, teknikoshkencor, monografi, fjalore, tekste shkollore, botim e tregetimi shtypshkrimesh, ngritjen e venin ne funksionim te shkollave te larta jopublikete nivelit universitar e shkencor per shkencasociale, politike, programe te edukimit profesional, seminare, kurse e trajnime etj. Aktiviteti ne fushen e arsimimit para-universitar nepermjet hapjes se gjimnazeve, kolegeve, kurseve per trajnime profesionale te ndryshme, ofrimin e kurseve te formimit profesional per gjuhete anglisht, italisht, gjermanisht, frengjisht, spanjisht, shqip etj. Veprimtari ne fushen e perkthimit, botimit, shitjen e gazetave, revista, libra artistik, historik, teknikoshkencor, monografi, fjalore, teksteshk allore, botim e tregetim shtypshkrimesh, ngritjen e venin ne funksionim te shkollavete larta jopublikete nivelit universitar e shkencor per shkencasociale, politike, programe te edukimit profesional, seminare, kurse e trajnime etj. Aktiviteti ne fushene arsimimit para-universitar nepermjet hapjes se gjimnazeve, kolegeve, kurseve per trajnime profesionale te ndryshme, ofrimin e kurseve te formimit profesional per gjuhete anglisht, italisht, gjermanisht, frengjisht, spanjisht, shqip etj. Trajnimin e punonjesve arsimor dhe cdo lloj trajnimi tjeter profesional ne fushen e menaxhimit, administrimit, teknologjise se informacionit, shkencave sociale dhe trajnime profesionale per perfshirjen e shtresave vulnerable, me aftesi te kufizuara, komunitetet Rome dhe Egjiptiane, si dhe nderjegjessimin e komunitetit per t'i pranuar dhe nxitur respektin ndaj punes se kryer prej ketyre shtresave. Cdo lloj trajnimi tjeter qe shoqeria ka kapacitetet e nevojshme njezore dhe financiare per realizimin e qellimit te tyre. Vleresim projektesh, anketime. Ofrimi i sherbimeve dhe konsulencave profesionale ne fushen ekonomike. Ofrimi i sherbimeve dhe konsulencave profesionale ne fushen e marketingut dhe Public Relationship (PR). Konsulence dhe asistence ne menaxhim projektesh ne fusha te ndryshme te jetes sociale. Aktivitete te ndryshme ne fushen e Real Estate. Ndermjetesim ne konflikte/kontradikta te sipermarrjeve dhe/ose individeve me natyre ekonomike. Analiza te detajuara te gjendjes ekonomike dhe raportimi ne formen e due diligence. Ofrimi i sherbimeve dhe konsulencave profesionale ne fushen e Teknologjise se Informacionit: Institucioneve publike dhe private, organizatave, SME-ve dhe kuji do qe ka nevoje per konsulence apo per nje produkt konkret ne fushen e teknologjise se informacionit. IT Consulting, IT Solutions, IT Consulting Services, IT Outsourcing, Web solutions, Websites, web applications, ecommerces, mobile solutions, SEO's, Back-end Systems. Ofrimi i sherbimeve dhe konsulencave profesionale ne fushen ligjore. Perfajesime ne gjykata, Perfajesime ne institucione shteterore dhe/ose private, Terapi individuale, Terapi grupi, Terapi ne çift, Ofrimin e keshillave individual te cilat mund te jete afatgjate ose afatshkurter, qe sherbejne si nje hallke e rrendesishme referimi per cdo problem individual, familjar, ne grup apo dhe ne popullate. Perpos keshillimit individual, ne çift, grup etj. ofrimin e sherbimit si nje qender per praktiken e keshillimit per studente universitar, si dhe nje qender e kerkimit shkencor ne psikologji. Projektme ne fushen e arkitekturore, ne fushen e design si dhe interior design. Hapjen e laboratoreve ne te gjitha fushat e njohura nga legjisllacioni ne fuqi duke respektuar kriteret dhe kushtet e posacme per hapjen e tyre. Shitje online te sherbimeve dhe te produkteve. Ndermjetesim. Gjithashtu per te realizuar objektin dhe qellimet e saj, shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, promocional apo dorezames qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te saj.



Objekti i shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te Asamblese se Ortakeve.

Gjithashtu per te realizuar objektin dhe qellimet e saj, Shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, promocional apo dorezanes qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arrijten e qellimeve te saj.

NENI 4 KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar. Afati i veprimtarise fillon nga momenti i regjistrimit te shoqerise ne regjistrin e shoqerive tregetare qe administrohet pran Qendras Kombetare te Biznesit.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 250.000.000 ALL (dyqinde e pesedhjete milione leke) dhe eshte i perbere nga 1 (nje) kuote me vlere nominale 250.000.000 ALL (dyqinde e pesedhjete milione leke).

Kapitali themeltar zoterohet totalisht nga ortaku i vetem **EUROPEAN EDUCATION INITIATIVE HOLDING**.

NENI 6 KALIMI I KUOTAVE

Pjeset e kapitalit themeltar jane nominative dhe te ndashme sipas ligjit. Te drejtat, perfshire edhe e drejta e votes, u takojne ortakeve ne perpjestim me kuotat qe secili zoteron ne kapitalin themeltar.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Ne rastin e kalimit te kuotave ne favor te te treteve, ortakeve te tjere te shoqerise u takon e drejta e parablerjes. Ortaku qe deshiron te transferoje, teresisht ose pjeserisht, kuotat e pjesemarrjes se tij ne shoqeri duhet t'ju komunikojte ortakeve te tjere nepermjet leter rekomande, oferten e marre, duke treguar emrin e blesesit dhe kushtet e tjetersimit, ne menyre te veçante çmimin e caktuar dhe modalitetet e pageses. Ortaku/ortaket e interesuar, brenda tridhjete diteve nga marrja dijeni, duhet t'i komunikojne ortakut qe tjeterson te drejtat, nepermjet letrre rekomande, interesin per te ushtruar te drejten e parablerjes, duke perfshire, eventualisht, edhe interesin per blerjen e pjeses se kuotave per te cilen nuk eshte ushtruar e drejta e parablerjes nga ana e ortakeve te tjere. Eshte i pavlefshem çdo njoftim qe nuk permban te gjithe te dhenat e mesiperme.

Ne rast se asnje prej personave qe kane te drejten e parablerjes nuk mund ose nuk deshiron ta ushtroje ate, e drejta qe u takon zmadhohet automatikisht dhe perpjestimisht ne favor te ortakeve te tjere qe kane shprehur interesin e tyre ne ushtrimin e kesaj te drejte. Ne rast se

disa ortake, qe marrin oferten, ushtrojne te drejten e parablerjes, kuotat do te ndahen ndermjet tyre ne perpjestim me pjeset respektive te kapitalit themeltar qe zoterojne.

Ne rast se ne lefren e komunikimit tregohet nje person qe ben pjese ne shoqeri, edhe ketij te fundit i perket e drejta e parablerjes krahas ortakeve te tjere. E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet per te gjithë pjesemarrjen e ofruar, pasi i tille eshte objekti i propozimit te formuluar nga ortaku ofrues. Parablerja duhet te ushtrohet per çmimin e percaktuar nga ofruesi.

Nese parablerja nuk ushtrohet brenda afateve te treguara me siper dhe per teresine e pjesemarrjes se ofruar, ortaku ofrues mund t'i transferoje kuotat e veta ne favor te blesesit te treguar ne komunikim dhe ne kushtet e parashikuara ne te, pasi te kete marre pelqimin paraprak te ortakeve qe perfaqesojne te pakten e gjysmes se kapitalit themeltar.

Pelqimi i ortakeve mund te mohohet nese blesesi i propozuar ndodhet ne njerën nga kushtet si me poshte:

- eshte denuar per nje veper penale me vendim gjyqesor, edhe nese nuk ka marre ende formen e prere;
- i eshte hequr ose kufizuar zotesia per te vepruar, ka falimentuar, ose eshte denuar me nje denim plotesues qe sjell ndalimin, edhe te perkohshem, te se drejtes per te ushtruar funksione publike ose detyra drejtuese prane personave juridike;
- ne momentin e transferimit te pjesemarrjes, nuk merr persiper detyrimin kundrejt shoqerise te kryeje sherbimet aksesore per te cilat detyrohej ortaku shites;
- ushtron, per llogari te vet ose te dikujt tjeter nje veprimtari konkuruese me ate te shoqerise.

Ne rast se pelqimi i ortakeve mohohet gjithsesi, edhe jashte rasteve te parashikuara me lart, ortaku gezon te drejten e largimit nga shoqeria, sipas afateve dhe modaliteteve te parashikuara nga neni 101 i Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar.

NENI 7

VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE


Asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos mbi çeshtjet qe i rezervohen kompetences se saj nga ligji dhe nga ky Statut .

Asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos me shumice te zakonshme te votave te ortakeve pjesemarrres ne lidhje me te gjitha çeshtjet qe nuk kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 9 te ketij statuti, ne rast se ne asamble marrin pjese ortaket qe zoterojne te pakten ose me shume se 30% (tridhjetë perqind) te kuotave.

NENI 8

MBLEDHJA E ORTAKUT TE VETEM

Ne rast se kuotat e kapitalit themeltar zoterohen teresisht nga nje ortak i vetem do te zbatohen dispozitat e posaçme te Ligjit Tregtar, si dhe dispozitat e ketij statuti per sa jane te aplikueshme per shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me ortak te vetem.



NENI 9 VENDIMET ME SHUMICE TE KUALIFIKUAR

Asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos me tre te katertat e votave te ortakeve, mbi ndryshimet e ketij Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Ne asnje rast, shumica nuk mund te detyroje ndonje prej ortakeve te zmadhoje angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 10 THIRRJA E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e pergjithshme e ortakeve e thirrur ne menyre te rregullt perfaqeson teresine e ortakeve dhe vendimet e saj, te marra konform ligjit dhe ketij statuti, jane te detyrueshme per te gjithe ortaket, edhe nese keta mungojne ose nuk jane te te njejtit mendim.

Asambleja thirret nga administratori nepermjet njoftimi me shkrese derguar ortakeve. Asambleja mund te thirret edhe nepermjet postes elektronike.

Ne njoftimin e thirjes duhet te tregohen vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista e qeshtjeve qe do te trajtohen. Ne mungese te formaliteteve te mesiperme, asambleja e pergjithshme e ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord per te marre vendime pavaresisht parregullsise ne thirje.

Ortaket kane te drejten e pjesemarrjes ne asamble dhe gezojne te drejten e votes ne perpjestim me pjesemarrjen e secilit prej tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Vendimet e asamblese se pergjithshme te ortakeve duhet te regjistrohen ne procesverbalin e nenshkruar nga kryetari dhe mbajtesi i procesverbalit.

NENI 11 ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Organi i vetem Administrativ i shoqerise eshte Administratori i saj i vetem

- **Arbi Agalliu**, shtetas shqiptar, lindur me 01.08.1984 ne Vlore dhe banues ne Tirane, mbajtes i Leternjoftimit ID me Nr. 024408042 dhe me numer personal I40801080F, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

qe do te qendroje ne detyre per nje periudhe prej 4 vjetesh nga data e emerimit me te drejte rizgjedhjeje.

Nuk mund te emerohen ne detyren e administratorit dhe, nese jane emeruar, duhet te shkarkohen, personat te cileve u eshte hequr ose kufizuar aftesia per te vepruar, kane falimentuar ose u eshte ndaluar, edhe perkohesisht, e drejta per te ushtruar funksione publike ose detyra drejtuese prane personave juridike, si rrjedhoje e nje vendimi penal.

Cdo emerim qe bie ndeshe me interesat e shoqerise nuk do te konsiderohet si konflikt interesi nese mer votbesimin e te pakten 51% (pesedhete e nje perqinde) te ortakeve.

Ne rast emerimi per nje afat te caktuar, detyra e tyre perfundon ne daten e asamblese se thirrur per miratimin e bilancit te vitit te fundit ushtrimor te mandatit te tyre.

 5

Perfundimi i mandatit të administratorit për shkak të përfundimit të afatit ka efekt nga momenti i riformimit të organit administrativ.

NENI 12 KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratorët kanë të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, në përputhje me sa është parashikuar nga ligji, nga akti i themelimit dhe nga ky statut. Ata gëzojnë të drejta dhe fuqi të plota për kryerjen e çdo veprimi që vlerësojnë të dobishëm për realizimin e objektivave të shoqërisë, me përjashtim të atyre që duhet të merren me vendim të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve. Në mënyrë të veçantë, hyjnë në kompetencat e organit administrativ veprimtaritë e mëposhtme :

- a) Hartimi i inventarit, llogarive vjetore dhe raportit me shkrim mbi administrimin, në mbylljen e çdo viti financiar;
- b) Hartimi i projekteve të bashkimit dhe ndarjes së shoqërisë;
- c) Propozimi për celjen apo mbylljen e degeve, filialeve, zyrave të përfaqësimit të shoqërisë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- d) Përgatitja e relacioneve mbi marrëveshjet e mundshme të realizuara ndërmjet shoqërisë dhe një prej administratorëve ose ortakëve të saj.

Në rastin e disa administratorëve, secili prej tyre mund të ushtrojë veçmas të gjitha veprimet për administrimin e zakonshëm të shoqërisë.

Administratorët mund të emerojnë përfaqësues të posaçëm për kryerjen e akteve të veçanta ose të një kategorie aktesh, duke përcaktuar kompetencat përkatëse.

Në rast kundërshtimi të njerit prej administratorëve ndaj akteve që synon të kryejë një tjetër, kompetenca për të vendosur mbi kundërshtimin i përket Asamblesë së Ortakëve.

NENI 13 PERFAQESIMI

Administratori ushtron i vetëm përfaqësimin e përgjithshëm të shoqërisë kundrejt të tretëve dhe në gjykim. Ai mund të caktojë avokate dhe përfaqësues të shoqërisë përpara organeve gjyqësore, organeve të administratës shtetërore dhe të tretëve, si dhe përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose kategori aktesh.

Në rastin e disa administratorëve, administratorët ndërmjet tyre zgjedhin kryetarin dhe marrin vendime me shumicë të thjeshtë të të gjithë antarëve.

Kryetari ka të drejtën e përfaqësimit ndaj palëve të treta vetëm mbasi të ketë marrë votëbesimin e antarëve të tjerë.

NENI 14 VITI USHTRIMOR DHE BILANCI

Viti ushtrimor fillon me 01 janar dhe mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo viti ushtrimor, organi administrativ procedon me hartimin e bilancit të vitit ushtrimor, brenda afateve dhe në përputhje me dispozitat e ligjit.

 6

Dokumentat e kontabilitetit, te shoqeruar, nese jane te nevojshem, nga raporti i eksperteve kontabel te autorizuar duhet tu komunikohen dhe tu vihen ne dispozicion ortakeve prane selise se shoqerise te pakten pesembedhjete dite perpara dates se Asamblese.

Viti i pare ushtrimor fillon ne daten e themelimit te shoqerise dhe perfundon me 31 dhjetor te atij viti.

NENI 15 FINANCIMI I ORTAKEVE

Shoqeria mund te marre nga ortaket kontribute ne te holla dhe hua, me ose pa kamate, ne perputhje me dispozitat ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Dhenia e ketyre financimeve nga ana e ortakeve eshte e lire.

NENI 16 PRISHJA E SHOQERISE

Prishja e shoqerise vendoset nga Asambleja e pergjithshme e ortakeve me shumicat e parashikuara per ndryshimin e ketij statuti per nje nga shkaqet e meposhtme:

- 1) perfundim te afatit, nese ka;
- 2) pamundesi te funksionimit ose mosfunksionim te vazhdueshem te asamblese;
- 3) me vendim te asamblese se ortakeve;
- 4) per shkaqe te tjera te parashikuara me ligj.

NENI 17 ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet ortakeve ose ndermjet ortakeve dhe shoqerise dhe qe ka objekt te drejta te disponueshme ne lidhje me marredheniet e tyre me shoqerine do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 18 LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM


Gjithcka nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut do te disiplinohet nga dispozitat ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, per sa te aplikueshme.

Ky statut u hartua ne kater kopje te njejta ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet rregullisht nga ortaku i shoqerise.

ORTAKU I VETEM

Perparim Shkup

Q. ...



**Universiteti
European i
Tiranës**



Nr. 17 Prot. Datë 16 . 01 .2020

Nr. 55 Prot. Datë 16 . 1 .2020

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Sot më datë 16 / 1 / 2019 në Selinë e Universitetit Europian të Tiranës, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd. 70, H. 1, Tiranë, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme:

- **Shoqëria EUROPEAN EDUCATION INITIATIVE sh.p.k**, person juridik i së drejtës shqiptare, me emër tregtar “**UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS**” regjistruar në QKR me NIPT K62029010L, me seli në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta” Tiranë, përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. **Nevila Nika**, (këtu e më poshtë referuar si **UET**);

dhe

- **AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHQETIT**, person juridik publik, i pavarur, me seli në adresën: Rruga “Ibrahim Rugova”, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetarja, znj. Gentiana Sula, lindur në Tiranë, e datëlindjes 24.12.1969, (këtu e më poshtë referuar si **Autoriteti**);

Duke marrë parasysh se:

UET është një institucion jopublik i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i themeluar në vitin 2006, regjistruar me vendimin nr. 36117, të datës 7 Korrik 2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe lincensuar me vendimin nr. 636, datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave, rikredituar me vendimin nr. 12, të datës 07 Prill 2017, për pesë vitet e ardhshme akademike (2017-2022) nga Agjencia ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë, "Agjencia e Sigurimit". UET ka për qëllim shoqëror: “*a) të kryejë aktivitete mësimore dhe kërkimore, të kombinuara në mënyrë të integruar dhe në përputhje me planet mësimore të zbatuara; b) të kontribuojë në zhvillimin e arsimit universitar, kërkimin profesional dhe shkencor brenda vendit dhe ndërkombëtarisht; c) të krijojë dhe të mbajë mundësi për krijimin e një mjedisi të favorshëm për studentin, në mënyrë që këta të fundit të mund të hyjnë në botën e punës dhe shkencore; d) të promovojë zbatimin e projekteve të ndryshme shkencore në fushën e arsimit universitar, etj.*”.

Autoriteti është person juridik publik, i pavarur, i cili vepron sipas ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, me qëllim *mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to, duke bërë të mundur garantimin e së drejtës*



nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar.

Në kushtet kur Arsimit i Lartë në Republikën e Shqipërisë, si në të gjitha vendet e zhvilluara, konsiderohet si një shërbim publik dhe e mirë publike dhe realizohet në universitete publike dhe jopublike;

UET është aktiv në hapësirën e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor si në Shqipëri, ashtu dhe në arenën ndërkombëtare, në nisma inovatore dhe zhvilluese, në botime akademike dhe shkencore, në projekte ndërinstitucionale, në tregun e punës ku ofron një garanci për studentët, duke i paraprirë ndryshimeve që shfaq ekonomia e tregut;

Autoriteti [K1] e konsideron veprimtarinë e UET, i cili i ka kushtuar vëmendje arsimit të lartë, pasi interesi publik dhe ekonomik i vendit është krijimi i një mjedisi të favorshëm për studentin, në mënyrë që ky i fundit të mund të hyjë në botën e punës dhe atë shkencore; meqë UET siguron dhe ofron programe të ndërkombëtarizuara, kërkim shkencor dhe staf akademik me eksperiencë në universitetet perëndimore, ky universitet është qendër e rëndësishme kombëtare në arsimin e lartë;

Nisur nga rëndësia e kontributeve të të gjithë subjekteve të përfshirë në procesin e respektimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

Nisur nga rëndësia e komunikimit të drejtpërdrejtë mes universitetit dhe studentëve nga njëra anë, dhe organeve të pavarura publike që administrojnë informacion/dokumentacion të përdorshëm për interesa shkencore;

Duke ekzistuar gatishmëria reciproke për aktivizimin e një bashkëpunimi të frytshëm, në përbërjen sinergjike të përvojave dhe kompetencave përkatëse dhe me qëllim të realizimit të një sërë projektsh afatgjata në fushën: e kërkimit shkencor, edukimit qytetar të bazuar në të drejtat e njeriut për paqe dhe demokraci dhe kujtesës kolektive e raportit tonë me të shkuarën;

Me angazhimin për të asistuar njëri-tjetrin mbi parimin e reciprocitetit dhe me bindjen se bashkëveprimi është në ndihmën dhe interesin e studentëve;

Në dritën e sa më sipër, Palët kanë vlerësuar pozitivisht mundësinë e bashkëpunimit për realizimin e qëllimeve të tyre institucionale;

Atëherë (kësisoj) Palët synojnë të rregullojnë me këtë memorandum, bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm, duke përcaktuar parimet e përgjithshme që do të qeverisin (udhëheqin)

marrëdhëniet e tyre në kryerjen e aktiviteteve, duke përvijuar gjithashtu kontributet dhe angazhimet e tyre përkatëse:

Duke rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 OBJEKTI I MEMORANDUMIT

Kjo marrëveshje ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe modaliteteve brenda të cilave Palët do të zhvillojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre, për arritjen e objektivave të përbashkët.

Neni 2 QËLLIMI

Qëllimi i këtij Memorandumi është vendosja e urave të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e kujtesës, nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese dhe trajnimeve, për të rritur ndërgjegjësimin në brezat e rinj, nëpërmjet edukimit qytetar dhe mbështetjes së kërkimit shkencor, mbështetur kjo në planet vjetore të shkëmbyera të palëve, në emër të një të ardhmeje më të mirë.

Neni 3 BAZA LIGJORE

Baza ligjore e kësaj Marrëveshjeje është ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, neni 17 i Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr. 21, datë 09.05.2017, VKM nr. 93, datë 27.02.2019, “Për përcaktimin e tarifave dhe të pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, Rezoluta nr.11 “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri” (2006) dhe Rezoluta “Për dënimin e krimeve të komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e veçantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” (2016), të Kuvendit të Shqipërisë, Rezoluta e Parlamentit Europian mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane (2019) dhe parimet e Rrjetit Europian të Kujtesës dhe Solidaritetit, Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në Republikën e Shqipërisë”, dhe aktet nënligjore të nxjerrë në zbatim të tij.

Neni 4 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

- Palët njohin interesin e përbashkët në ruajtjen dhe zhvillimin e formave të bashkëpunimit, për ofrimin e shërbimeve dhe mbështetje të shkëmbimit të përvojave midis tyre, trajnimit dhe kërkimit shkencor në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Palët angazhohen të bashkëpunojnë në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese dhe trajnimeve (zhvillimi i leksioneve të hapura me tematika të ndryshme, zhvillimin e ekspozitave,





simpoziumeve, seminareve dhe/ose konferencave të përbashkëta), me qëllim rritjen e veprimtarive ndërgjegjësuese, të edukimit qytetar dhe mbështetjes së kërkimit shkencor, të organizuara nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; informimin mbi dokumentet arkivore që lidhen me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, të cilat AIDSSH i disponon në arkiva.

- Palët do të udhëhiqen gjithnjë dhe mbi të gjitha nga interesi i publikut, në zbatim të ligjit 45/2015 sipas të cilit funksionon AIDSSH, për të krijuar mundësi të aplikojnë për intership, kërkim shkencor, projekte ndërvepruese të edukimit qytetar, master, etj;
- Palët angazhohen të mbështesin njëra-tjetrën në realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes reciprok;
- Palët mund të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera, për të cilat mund të bihet dakord në të ardhmen, në përshtatje me planet e tyre vjetore të shkëmbyera.
- Palët marrin përsipër që të vendosin në dispozicion të njëra-tjetrës burime njerëzore dhe materiale, në përputhje me ligjin, për arritjen e qëllimeve që parashikon ky memorandum.
- Palët do të ruajnë konfidencialitetin, për të cilin do të vihen në dijeni si rezultat i bashkëpunimit të ndërsjellë.
- Palët do të inkurajojnë bashkëpunim të zgjeruar në fushat e sipërpërmendura.
- Palët bien dakord që bashkëpunimi i tyre do të respektojë dhe nuk do të cenojë aktet ligjore dhe nënligjore, mbi të cilën funksionojnë palët si dhe praktikrat e mira, traditë e tyre.

Neni 5 PRONËSIA INTELEKTUALE

1. Të gjitha pronat intelektuale (intervista, dëshmi, filma, etj.) të zotëruara nga secila Palë para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të mbeten pronë e vetme e Palës e cila i ka në pronësi. Pronësia intelektuale e krijuar si rezultat i bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në pronësi të përbashkët e të dyja palëve.
2. AIDSSH nuk mban përgjegjësi për interpretimin e materialeve që vë në dispozicion dhe në çdo rast distancohet nga gjuha e urrejtjes në trajtimin e tyre.
3. Palët i japin leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë, njëri-tjetrit, për të përdorur materialet (në çfarëdo lloj forme qofshin) në pronësi të secilit, në mbështetje të këtij bashkëpunimi dhe planeve vjetore të shkëmbyera reciprokisht, temave master dhe doktoraturë të miratuara, për një periudhë kohe dy vjeçare [K2].
4. Në raste të tjera të kërkesave mediatike të UET aplikohet tarifa e vendosur me ligjin funksional 45/2015 dhe me VKM nr. 93, datë 27/02/2019.

Neni 6 KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

1. Në zbatim të këtij Memorandumi, **AIDSSH** dhe **UET** do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për marrje dhe dhënie të informacionit dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit elektronik.
4. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

Neni 7 PËRMIRËSIMET, NDRYSHIMET, SHITESAT

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë Marrëveshje, bazuar në pëlqimin e tyre të ndërsjellë.
2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e **AIDSSH** dhe **UET**, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.


Neni 8 MIRËBESIMI

1. **AIDSSH** dhe **UET** do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim dhe të përdorin sipas fushës së veprimit të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Memorandum.
3. Vështirësitë e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi do të zgjidhen nëpërmjet bisedave në mirëbesim, me negociata midis Palëve.

Neni 9 AFATI I MEMORANDUMIT

1. Ky Memorandum do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Memorandumi mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër (të paktën një muaj përpara).
3. Në rast të përfundimit të këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

Neni 10 INTERPRETIMET





Palët do të interpretojnë çdo pikë të këtij Memorandumi duke marrë parasysh vullnetin dhe dëshirën e mirë që i ka sjellë deri në nënshkrimin e tij.

Neni 11 DISPOZITA TË FUNDIT

Ky Memorandum lidhet për një periudhë dyvjeçare dhe do të jetë efektiv për sa kohë do të gjykohet si i nevojshëm dhe i domosdoshëm bashkëpunimi midis palëve.

Çdo palë mund të kërkojë zgjidhjen e memorandumit, duke njoftuar palën tjetër 30 ditë para.

Palët në këtë Memorandum Bashkëpunimi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për ekzekutimin sa më efektiv të të gjitha detyrimeve të marra përsipër prej tyre.

Ky memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

Memorandumi përpilohet në gjuhën shqipe në 2 (dy) kopje me vlerë të njëjtë ligjore ku secila palë merr një të një prej tyre.

Ky memorandum përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve, të cilat, pasi e lexojnë dhe pasi gjejnë të shprehur në të vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, e nënshkruajnë atë rregullisht për të gjitha efektet e ligjit.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë ___/___/2020.

PALËT

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

REKTORI


Prof. Dr. Nevila Nika

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT**

KRYETARJA


Gentiana Sula